

*EC Ma Ndryshe, Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Forumi për Trashëgimi Kulturore, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren, GreenArt, X40, EUIRC, Ura e Artit, Durmish Asllano, ICEC, Old timer Club Prizren, Shoqata e Bjeshtatarëve Sharri*

**PËR:** Presidencën e Republikës së Kosovës  
Presidenten e Republikës së Kosovës, Znj. Atifete JAHJAGA

**CC:** Z. Ilir Deda, këshilltar i lartë politik i Presidentes

**NGA:** OJQ EC Ma Ndryshe, në emër të 14 OJQ-ve të poshtënjshkruara  
Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv i EC Ma Ndryshe

**DATË:** 27 tetor 2011, Prishtinë

## **KËRKESË PËR TAKIM**

*Në lidhje me procesin e hartimit dhe miratimit të projekt-ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit*

E nderuara Zonja Presidente,

Shoqëria civile dhe qytetarët e Prizrenit nga viti 2009 janë duke i artikuluar pakënaqësitë e tyre në lidhje me procesin e hartimit dhe miratimit eventual të projekt-ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, të sponsoruar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe aktualisht në procedurë të shqyrtimit parlamentar. Deri tani, kemi përdorur mjete të ndryshme të shprehjes së pakënaqësisë sonë në lidhje me këtë projekt-ligj. Në një nga veprimet tona, kemi dorëzuar edhe Peticionin e qytetarëve të Prizrenit (me mbi 10.000 nënshkrime) për të kundërshtuar këtë projekt-ligj, por edhe procesin jodemokratik dhe përjashtues të hartimit të tij. Edhe pse kanë kaluar mbi një muaj nga dita e dorëzimit, Kuvendi i Kosovës ende nuk është deklaruar, por as nuk ka hyrë në dialog me OJQ-të sponsorizuese në lidhje me Peticionin e qytetarëve të Prizrenit. Derisa Kuvendi i Kosovës nuk po deklarohet rreth Peticionit dhe nuk po ndërmerr veprime konkrete për të respektuar vullnetin e shprehur të qytetarëve të Prizrenit, po ndodhin shumë veprime të dëmshme për demokracinë në Kosovë.

Një rast konkret është tentim-debati i javës së kaluar me shoqërinë civile i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ky debat është thirrur nga MMPH për të diskutuar rreth projekt-ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, që nënkupton proces të konsultimit publik për projekt-ligjin. Projekt-ligji për Qendrën Historike të Prizrenit aktualisht ndodhet në Kuvendin e Kosovës duke iu nënshtruar shqyrtimit parlamentar, prandaj Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk ka të drejtë të organizojë konsultime publike dhe të modifikojë përmbajtjen e projekt-ligjit. Me fjalë të tjera, kjo përpjekje e MMPH përbën shkelje ligjore si dhe degradim e nënçmim të autoritetit të Kuvendit të Kosovës. Për më tepër, përmbajtja aktuale e projekt-ligjit është refuzuar kohë më parë nga Kuvendi i Kosovës në seancë plenare, dy herë nga Komisioni parlamentar për Bujqësi dhe Planifikim Hapësinor, si dhe nga Komisioni parlamentar për të drejtat e njeriut. Edhe përkundër të gjitha refuzimeve, MMPH vazhdon të insistojë dhe të promovojë të njëjtën përmbajtje të projekt-ligjit, si dhe të organizojë konsultime publike në mënyrë joligjore, derisa projekt-ligji gjendet në fazën e shqyrtimit parlamentar.

Mbi të gjitha, qeveria e Kosovës është duke e promovuar nevojën e miratimit të këtij projekt-ligji, duke e ndërlidhur atë me Pakon e Ahtisaarit, me argumentin që miratimi i tij është obligim që del nga Pakoja. Duhet të sqarohet se ky konstatim është i gabueshëm, pasi që në asnjë pikë të Pakos së Ahtisaarit nuk përmendet obligimi për miratimin e një ligji, por vetëm kërkohet themelimi i zonës së veçantë të Qendrës Historike të Prizrenit. Për më tepër, Pakoja shprehimisht kërkon që kjo Qendër të themelohet nga komuna e Prizrenit. Rrjedhimisht, praktika e miratimit të këtij projekt-ligji nga institucionet qendrore të Kosovës përbën shkelje të Pakos së Ahtisaarit. Realisht, komuna e Prizrenit është lënë jashtë këtij procesi, ndërsa komuniteti i qytetit është duke u injoruar në mënyrë konstante, edhe pse ai tashmë e ka shprehur vullnetin e vet në formë të organizuar dhe kolektive.

Projekt-ligji aktual, përveç faktit që si formë e themelimit të Qendrës Historike të Prizrenit është në kundërshtim me Pakon e Ahtisaarit, ai edhe përmbajtësisht ka shumë të meta. Disa nga të metat e këtij projekt-ligji janë: transferimi i autoritetit publik tek autoritetet fetare që është në kundërshtim me parimet kushtetuese të sekularizmit dhe laizicmit, mungesa e një sistemi të menaxhimit urban të qendrës historike, ngufatja e potencialit zhvillimor të qytetit, mungesa e komponentës zhvillimore bazuar në potencialin e trashëgimisë kulturore, mbindërtimet institucionale në kundërshtim me logjikën e efektshmërisë së menaxhimit urban, imponon shumë ndalesa, burrokraci dhe pengesa ndërsa nuk parasheh kompensime, dhe shumë defekte të tjera.

Për të gjitha këto arsye, Koalicioni i OJQ-ve të Prizrenit shpreh dëshirën dhe kërkesën për një takim zyrtar me Presidenten e Kosovës, në mënyrë që të shpjegojmë pakënaqësitë dhe qëndrimet tona në lidhje me këtë projekt-ligj dhe të kërkojmë përkrahje nga institucioni i Presidencës në raport me respektimin e vullnetit të qytetarëve të Prizrenit.

Ju falemnderit paraprakisht për konsideratën dhe kohën tuaj.

Me respekt,  
Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv i OJQ EC Ma Ndryshe  
Në emër të Koalicionit të OJQ-ve të Prizrenit

*EC Ma Ndryshe,  
Fondacioni për Trashëgimi Kulturore,  
Forumi për Trashëgimi Kulturore,  
Academy for Training and Technical Assistance,  
N'GO,  
Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren,  
GreenArt,  
X40,  
EUIRC,  
Ura e Artit,  
Durmish Asllano,  
ICEC,  
Old timer Club Prizren,  
Shoqata e Bjeshkatarëve Sharri*